

DEMOKRACIA



**E MIRA E PËRBASHKËT E
QYTETARËVE**

ZHVILLIMI I DEMOKRACISË

MAJLINDA (11), ERION (11), GENT (11), GEART (11)



Ne mësuam se të gjithë jemi të barabartë sepse ne jetojmë në një shtet demokratik dhe të pavarur siç është Republika e Kosovës

Demokracia rrjedh nga fjala greke „demos“ që do të thotë popull, dhe nga fjala „kratia„ që do të thotë pushtet. Demokracia ka filluar në vitin 507 para erës sonë në Greqi. Atë kohë nuk kishte shumë të drejta dhe votonin vetëm burrat që ishin të pasur, gjersa gratë dhe të varfërit nuk kanë pasur të drejtë të voto-

vendime politike, por këto vendime merren nga përfaqësuesit e popullit të cilët janë deputetët. Kosova është shpallur shtet i pavarur dhe demokratik më 17 shkurt të vitit 2008. Në vendin tonë është demokracia përfaqësuese parlamentare. Kosova ka Kuvendin e vet, dhe aty miratojnë ligje deputetët. Ligjet tona ne duhet t'i respektojmë. Nëse ne nuk i respektojmë ato, ne biejmë ndesh me ligjet. Kosova sot është e zhvilluar, por ne do të punojmë që ta zhvillojmë atë edhe më shumë.



Grupi i katër gazetarëve duke punuar për demokraci



Fëmijët duke shkuar në shkollë

jnë. Në ditët e sotme mund të votojmë të gjithë, dhe të gjithë jemi të barabartë. Në demokraci ne kemi të drejtat tona dhe ato janë: e drejta për të jetuar, e drejta për t'u shkolluar, e drejta për t'u ushqyer, e drejta për t'u strehuar, e drejta për të punuar, etj. Demokracia ndahet në dy forma, në demokraci përfaqësuese dhe atë të drejtpërdrejtë. Në demokracinë e drejtpërdrejtë, vendimet politike merren direkt nga populli. Edhe në demokracinë përfaqësuese populli ka të drejtë të merr



Gazetarët e grupit 4

ZGJEDHJET, PROCES I RËNDËSISHËM

ANDI (11), DAOLIN (11), LAURA (11), ARDI (11), EGZONA (12)



Çfarë kuptojmë me zgjedhjet?

Çdo qytetar ka të drejtën e votimit, por për të marrë pjesë në procesin zgjedhor duhet t'i mbush 18 vjet, sepse atëherë ne jemi më të vetëdijshëm. Zgjedhjet janë proces, gjatë të cilit qytetarët zgjedhin përfaqësuesin e tyre, me anë të votave. Qytetarët nuk kanë të drejtë të votojnë më shumë se një herë, dhe për këtë arsye, qytetarët kontrollohen nëse kanë votuar më parë.

Përfaqësuesit e popullit janë deputetët. Deputetët zgjedhen me votim të fshehtë, të barabartë dhe pa imponime. Në fushata parazgjedhore, kandidatët japin premtime në të mirën e qytetarëve që t'i zgjedhin ata si përfaqësues.

Zgjedhjet ndahen në zgjedhje parlamentare dhe ato komunale. Mandati i një deputeti zgjat 4 vjet.

Sot në grupin tonë u mbajtën zgjedhjet parlamentare, ku kandidatët dhanë premtime të ndryshme. Partitë që morën pjesë në procesin zgjedhor ishin: Partia e Kuqe (PK), Partia e Artë (PA), Partia e Portokalltë (PP), Portokallia e Klasës V-3 (PEK), Partia e Kaltër (PK). Me shumicë votash në orën 10:18, kandidati i Partisë së Klasës V-3 (PEK) fitoi zgjedhjet tona parlamentare.

Kandidati i Partisë së Klasës V-3 premtoi që do t'i rriste rrogat e qytetarëve deri në 60%, po ashtu edhe pensionet. Gjithashtu, do të rritej buxheti i Kosovës nëse zgjedhjet do t'i fitonte ai. Ai premtoi se do të

punësonte 300.000 qytetarë.

A do t'i realizojë ai këto premtime?! Që t'i realizoj një deputet premtimet e dhëna, ai duhet të jetë i përgjegjshëm dhe i besueshëm. Por, pse është e rëndësishme të votojmë?

Është e rëndësishme që të votojmë, sepse ne me votën tonë vendosim se kush do ta udhëheqë vendin tonë. Pasi ka kaq shumë ndikim në të ardhmen e popullit, të gjithë qytetarët e përgjegjshëm votojnë në procesin zgjedhor.

Pra, në sistemin demokratik kemi të gjithë të drejta të barabarta. Të gjithë kemi të drejtën e votës, të drejtën e zgjedhjes së lirë, etj.



Autorët e artikullit

JA SE SI FUNKSIONON NDARJA E PUSHTETIT

ALBIN (12), ALKETA (11), DIJANE (11), ENTON (11), FATON (11)


Mënyra më demokratike për funksionimin e një shteti është që secili institucion të kryejë detyrat në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri. Në artikullin tonë do të informoheni më shumë rreth ndarjes së pushtetit. Pra, do të mësoni për Sistemin Gjyqësor, për Pushtetin Legjislativ si dhe Pushtetin Ekzekutiv

Demokracia, është sistem që të gjitha institucioneve iu mundëson të jenë në harmoni me njëra-tjetrën. Kosova ka një sistem të tillë, sepse të gjitha institucionet e saj punojnë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra. Por, secili ka detyrat dhe përgjegjësitë e veta në mënyrë që asnjëri prej këtyre institucioneve të mos ketë fuqi ose detyra më shumë se tjetri.

Ndarja e pushtetit në Kosovë ushtrohet nga tri institucione shumë të rëndësishme dhe të cilat janë: Pushteti Gjyqësor që e ushtron gjykata, Pushteti Ekzekutiv që e ushtron Qeveria, si dhe Pushteti Legjislativ i cili ushtrohet nga Kuvendi.



Ndarja e detyrave brenda grupit



Llojet e gjykatave në Kosovë



Albini dhe Fatoni duke vizatuar



Funksionet e Kuvendit



Nëse e shkelim ligjin, gjykata na dënon

Si funksionon Kuvendi i Kosovës?

Kuvendi i Kosovës është institucioni më demokratik, sepse deputetët të cilët ndryshe quhen përfaqësuesit e popullit janë të zgjedhur direkt nga populli, me mandat 4 vjeçar dhe të cilët kanë të drejtë të rizgjedhen. Disa nga detyrat që Kuvendi i ka është të miratoj ligjet të cilat i propozon Qeveria. Kuvendi, po ashtu e mbikëqyr Qeverinë nëse ajo është duke i zbatuar detyrat e saj. Si dhe më demokratikja, është funksioni përfaqësues i Kuvendit, sepse ai e përfaqëson popullin, i cili e ka votuar. Edhe Kushtetuta e Kosovës, e parasheh që edhe pse deputetët i përkasin një partie politike, prapëseprapë ata duhet të përfaqësojnë popullin dhe interesat e tij.

Si funksionon Qeveria e Kosovës?

Qeveria është një ndër elementet kryesore për funksionimin e një shteti. Pra, qeveria është elementi i tretë, sepse i pari është territori, pastaj është populli dhe i treti me radhë është ky institucion i rëndësishëm. Në Kosovë, Pushteti Ekzekutiv ushtrohet nga Qeveria jonë, që do të thotë se është ajo institucioni, i cili i përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme të një shteti, e në këtë rast të shtetit tonë, Kosovës. Në përbërje të Qeverisë së Kosovës kemi Kryeministrin (i cili e udhëheq Qeverinë), si dhe zëvendëskryeministrat me ministrat të cilët kanë përgjegjësi për detyrat që duhet t'i zbatoj Qeveria. Këto të dy institucione janë institucionet më të rëndësishme të shtetit.




Informata për Kuvendin e Kosovës



Entoni duke vizatur objektin e Qeverisë



Një vizatim se si duket Kuvendi i Kosovës



Kandidatët për deputetë, vizatim i punuar nga Entoni

Republika e Kosovës ka disa ministri që janë të udhëhequra nga ministra të ndryshëm. Kemi Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Diasporës, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë e Shëndetësisë, etj. Për secilën ministri është përgjegjës një ministër i caktuar. Por, si formohet Qeveria e Kosovës? Për të formuar Qeverinë, Presidenti i Kosovës së pari iu drejtohet partisë/partive e cila ka fituar shumicën e vendeve në Kuvend.

Kryeministri është ai i cili e koordinon punën mes ministrave në mënyrë që të sigurohet uniteti mes tyre. Grupi ynë sot kishte për temë diskutimi ndarjen e pushtetit, se si funksionon dhe cilat janë ato institucione që i ushtrojnë detyrat ndaras nga njëra-tjetra. Gjatë ditës së sotme, ne mësuam për Kuvendin si Pushtet Legjislativ, po ashtu mësuam për gjykatat, bashkë me funksionin e tyre gjyqësor të cilin e kanë, dhe në fund mësuam për Qeverinë, e cila ushtron funksionin ekzekutiv në një shtet demokratik. E gjithë kjo ndarje, ne mësuam se është bërë për të funksionuar sa më mirë shteti ynë demokratik.

KUSH ËSHTË QYTETAR I MIRË?

VELSA (11), GETOAR (11), ALBIN (11), DIAR (11), ERJONA (11)

Dëshironi të mësoni se çfarë bën një qytetar i mirë? Mësojeni këtë në artikullin tonë

Qytetar konsiderohet çdo person, i cili jeton brenda një shteti të caktuar, e që ka leje banimi në atë vend. Pra, të gjithë ne jemi qytetarë të Kosovës. Prandaj, si qytetar kemi të drejta dhe përgjegjësi. Për shembull, disa nga të drejtat tona janë: të shprehemi lirshëm, të jemi të barabartë, të shkollohemi, të punojmë, të jetojmë të lirë dhe në paqe.

Disa nga përgjegjësitë tona janë: të respektojmë ligjin, të respektojmë të moshuarit, të ruajmë dhe ta pastrojmë ambientin, etj. Një qytetar i mirë merr pjesë në protesta paqësore, dhe merr pjesë në aktivitete të ndryshme aktiviste. Ne edhe si fëmijë premtojmë se do të jemi të respektueshëm dhe qytetarë të përgjegjshëm.



Autorët e artikullit




Velsa tregon se qytetarët janë të barabartë pa dallim feje, race, kombi



Ligjin duhet ta respektojmë të gjithë, sepse është për të mirën tonë



Ta respektojmë njëri-tjetrin pa mohuar të drejtat tona



Duhet ta ruajmë ambientin për të mirën tonë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Pjetër Bogdani“
Klasa: VI-3
Vendi: Prishtinë